

VENDIM
Nr. 538, datë 9.7.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I TROTUAREVE, LAGJJA ‘SHEH’”, BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të bashkëpronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i trotuareve, lagjja ‘Sheh’”, Bashkia Kavajë.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Kavajë.

3. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 452 308 (katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 452 308 (katërqind e pesëdhjetë e dy mijë e treqind e tetë) lekësh përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Kavajë.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim, pranë Bashkisë Kavajë.

8. Bashkia Kavajë kryen procedurat për likuidimin e bashkëpronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Kavajë.

10. Bashkia Kavajë, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë, e cila, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Kavajë për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Kavajë, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës–Kavajë–Krujë dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN
NGA SHPRONËSIMI, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “RIKONSTRUKSION I TROTUAREVE LAGJJA ‘SHEH’”
BASHKIA KAVAJË

Nr.	Pronari			Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë)										Vlerësimi për shpronësim Lloji “truall”			Vlerësimi për “ndërtesë”			Vlera totale (lekë)	Shënime	
	Emër	Atësi	Mbiemër	Fshati ose qyteti	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqe totale	Arë (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volum	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmim (lekë/m²)	Vera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmim (lekë/m²)	Vera (lekë)			
1	Hysen Dhurata Flutura Gezim Mentor Yllka Ilaria Nikolas Yllka	Zenel Qemal Qemal Qemal Fehemi Fehemi Claudio Gazment Fehmi	Shehi Cara Beqari Shehi Shehi Gjeçi (Shehi) Taddei Shehi Shehi	Kavajë	8552	8/148	Truall	577		577	194.82	10	128	58.4	7,745	452,308				452,308		
VLERA TOTALE																					452,308	